

Specifikimet teknike

Të përgjithshme. Zona Perëndimore

Bashkia ka si qëllim ofrimin e shërbimit të Pastrimit në të gjithë territorin e saj aktual me standarte dhe performancë sa më të larta, duke siguruar reduktimin e impakteve negative të mbetjeve në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit.

- Kompania private duhet të kryejë grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të prodhuara në zonën Perëndimore dhe të realizojë depozitimin e tyre në landfillin e Bushatit.
- Eshtë parashikuar që në zonën Perëndimore çdo ditë prodhohen respektivisht 7.4 ton mbetje/ditë, kjo për Njësitë administrative, ndërsa për Plazhin gjatë 100 ditëve prodhohen mesatarisht 18.25 ton mbetje /ditë.
- Gjithashtu kompania duhet të kryejë edhe zëra të tjerë shërbimi të detajuara si më poshte sipas dhe preventivit të shërbimit.

E rëndësishme.

Llogaria e kostos për shërbimin e Pastrimit do të bëhet sipas modelit “ Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve “ miratuar me VKM nr.319 date 31.05.2018. Këtu përfshihen të gjitha elementet e këtij shërbimi sipas specifikimeve të mëposhtme. Proces pune në vete jashtë kësaj metodologjie është dizefektimi i PGM , fshirja manuale, punonjës për mirëmbajtjen e plazhit si dhe puntor për mirëmbajtjen e tualeteve publike. (cmimet e këtyre të fundit do të bëhen me analiza)

1 Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve

1.1 Volumet e punimeve

Në zonën Lindore bëjnë pjesë NJA Velipojë, Dajç, Berdicë, Ana Malit.. Kjo zonë ka një popullsi prej 23153 banorë (sipas të dhënave nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë) pa zonën e plazhit në Velipojë, dhe gjatë stinës së verës zona e plazhit në Velipojë ka rreth 25,000 turistë. Zona ka karakter sub-urban nëqendrat e NJA Bërdicë, Ana Malit, Dajç dhe Velipojë dhe karakter urban në zonën e plazhit në NJA Velipojë.

Në total në zone gjenerohen 7.4 ton/ditë mbetje të ngurta urbane, ose 2704 ton mbetje të ngurta urbane gjatë gjithë viti, si dhe per Plazhin një normë gjenerimi prej 18.25 ton /dita në 100 ditëshin e sezonit. Mbetjet urbane duhet të grumbullohen dhe transportohen në landfillin e Bushatit.

Kjo sasi mbetjesh do të mblidhet në terren nga 304 kontenierë metalikë me kapacitet 1,100 litra (1.1m³) të shtrirë në njësitë administrative Dajç, Berdicë dhe Ana malit. Ndersa per nja Velipoje dhe per Plazhin do te kemi 200 kontaniere.. Këto kontenierë janë pronë e bashkisë. Sipas planit të përcaktuar nga bashkia për vendosjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve, distanca midis tyre varion nga 150-200m larg. Në zonat e qendrave të NJA-ve dhe në zonën e plazhit në shumë raste pikat e grumbullimit të mbetjeve janë edhe në distancën 50m larg.

1.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

- a. Zbrazen e kontenierëve 1100 liter me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar, si dhe koshat e mbeturinave të parqeve dhe rrugeve pedonale.
- b. Mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 5 m nga çdo kontenier.
- c. Pastrim të sipërfaqes prej 30 m² rreth çdo pike grumbullimi.
- d. Rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur.
- e. Klorifikimi i zonës së kazanëve, sipas normativave.
- f. Larja e kazaneve sipas nje grafiku te miratuar.
- g. Mirembajtje dhe zevendesim i koshave sipas kerkeses.
- h. Transportin e mbeturinave në landfill.
- i. Mbledhja dhe transportimi i inerteve dhe mbetjeve të ndërtimit, një vit pas lidhjes së kontratës, me kosto vetjake.
- j. Mbledhja dhe transportimi i mbetjeve të rënda dhe voluminoze, me kosto vetjake.
- k. Mbledhja dhe transportimi i mbetjeve organike dhe atyre të kopshteve, një vit pas lidhjes së kontratës, me kosto vetjake.

1.3 Frekuencat e grumbullimit

a. Në zonën Perendimore shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do të ofrohet sipas grafikëve të përcaktuar. Oraret e grumbullimit do të jenë ditën nga ora 06.00 deri në orën 12.00, për Nj.A dhe për plazhin frekuenca dy herë në ditë turni parë rreth orës 14.00-17.00 dhe turni dyte 20.00- 06.00

b Zona Perëndimore: Parashikohen per Nj.A e kesaj zone të përdoren 2 mjete teknologjike 10ton, 1 mjet teknologjik 5ton për rrugët e ngushta rurale dhe për NJA Velipojë plazh 2 mjete teknologjike 5ton dhe kamioncin deri ne 3 ton per mbledhjen e mbetjeve ne zonen e reses, të cilët do të ofrojnë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve 2.5 herë në javë/1 turn në ditë për të gjithë zonën, përveç zonës së plazhit Velipojë, ku shërbimi do të kryhet 7 ditë të javës 2 herë në ditë (vetëm gjatë stinës së verës). Të dy mjetet teknologjike 10 ton do të ofrojnë përkatësisht shërbimin në dy

njësi mbrenda ditës (NJA Ana Malit – NJA Bërdicë – Landfill i Bushatit dhe NJA Velipojë pa zonën e plazhit – NJA Dajç – landfill i Bushatit). Në tabelën më poshtë propozohet një kalendar i mundshëm në lidhje me ditët e ofrimit të shërbimit në secilën nga njësitë vendore:

Frekuenca	2 Mjete 10 ton + 1 mjet 5ton						1 turn/ditë
	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E dielë
Zona perëndimore	Ana Malit	Velipojë	Pushim	Ana Malit	Velipojë	pushim	pushim
	Bërdicë	Dajç		Bërdicë	Dajç		

Përbërja	Infrastruktura		Të dhënat teknike	
	Mjetet	Kontenierë	Norma e gjenerimit	Frekuenca
Njësitë e Zonës Perëndimore				
Ana Malit, Bërdicë, Velipojë, Dajç	3 mjet 10 ton/ 1 turne (mjete i trete mund të merret 5ton për rrugët e ngushta)	Shtohen 100 (Total 243)	0.3 kg/banorë/ditë	2.5 herë/javë
Veipojë Plazh	2 mjete 5ton/2 turne	Shtohen 63 (Total 223)	0.75 kg/banorë/ditë	7ditë/javë/2 herë/ ditë

1.4 Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve

a. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit .

b. Kontraktuesi është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të kontraktuesit ose nga Autoriteti kontraktor sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontraktor.

c. Autoritetit kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mospërbushjen e tyre.

1.5 Rregulla për tu zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonën përreth kontenierëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e kontraktuesit dhe do të vendosen penalitete.

b. Kontraktuesi ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenierëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.

c. Kontraktuesi duhet të ketë në efikasitet një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-12.00 . Kontraktuesi duhet të vendosë dhe

komunikojë përmes lyerjes së kamionit të pastrimit numrin e telefonit si dhe adresën e internetit për ankesa. Përfaqësues të kontraktuesit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për t'u dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara pas marrjes së njoftimit. Kontraktori duhet të krijojë një listë (ose GIS) për ankesat me indikacionin për vendodhjen, tipin, përshkrimin dhe përcaktimin e masës së marrë. Kontraktori do të sigurojë një kopje javore të kësaj liste për Bashkinë.

d. Kontraktuesi detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.

e. Kontraktuesi detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

f. N.q.s gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballet me penaltetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoba të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

g. Përdorimi i uniformave dhe masave të sigurimit teknik për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjoba për mosplotësim këtij detyrimi.

1.6 Mjetet dhe pajisjet



Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

Kërkesa për mjete.

Nr	Emertimi I mjetit	Kapaciteti	Sasi (cop)
1	Mjete teknologjike pastrimi	10 ton	2
2	Mjete teknologjike pastrimi	5 ton	1
3	Mjete teknologjike pastrimi (sezonal per plazhin)	5 ton	2
4	Mjet kamioncin me sponda te mbilartesuara (sezonal per MU ne pjesen e reres , veteshkarkues)	3 ton	1
5	Mjet me cistern per larje kontanieresh		1
6	Mjete teknologjike pastrimi rezerve	5-10 ton	1

Lloji i mjetit	Mjet teknologjik grumbullues dhe transportues (kompaktor)
----------------	---

Ngarkimi fundor i makinës (kapaciteti i mjetit)	10ton/5ton 
Raporti i Kompaktimit	Komprimim të mjaftueshëm për të mbajtur sasinë e kërkuar të mbetjeve brenda volumit të kamionit (përkatësisht 10 dhe 5 ton)
Kapja e dhe ngarkimi i mjetit në pjesën fundore	Duhet të jetë me kra (1.1m ³) 
Rrotat e mjetit	Duhet të jenë rrota të mëdha të cilat të mund të lëvizin lirisht në territore malore dhe të mbuluara me borë
Viti i Prodhimit	Jo më poshtë se viti 2010
Lënda djegëse	Diesel
Marshi	Manual
Klasa e shkarkimit	Euro 5

a.Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10ton, Komprimim të mjaftueshëm për të mbajtur sasinë e kërkuar të mbetjeve brenda volumit të kamionit (përkatësisht 10 dhe 5 ton), i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **2 (dy) copë;**

b.Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 ton, Komprimim të mjaftueshëm për të mbajtur sasinë e kërkuar të mbetjeve brenda volumit të kamionit (përkatësisht 10 dhe 5 ton), i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak **1 (dy) copë;**

1.7 Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:

a. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.

b. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuara nga Autoriteti kontraktor. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjëndje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.

c. Mjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.

d. Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhen mesazhe për edukimin mjedisor, numri i telefoni i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht po nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu në të gjitha mjetet përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet të prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mbliidhen, si dhe orarin kur largohen mbeturinat.

e. Autoriteti Kontraktor në plan ka parashikuar një grafik të lëvizjes së mjeteve, por Kontraktuesi duhet të mundësojë një hartë të rrugës më eficiente që duhet të ndjek mjeti për grumbullimin e mbetjeve në zonën përkatëse dhe kalendarin përkatës.

f. Kontraktuesi do të realizojë instalimin e sistemit të GPS në të gjitha mjetet teknologjike e jo teknologjike. Autoritet kontraktor do lidhet me këtë system nga Kontraktuesi dhe do të ketë akses të plotë në kohe reale për të gjitha të dhënat. Kontraktuesi do mundësojë nëpërmjet Serverit qendror të sistemit GPS realizimin e sistemit të monitorimit edhe nga Autoriteti Kontraktor. Kjo do të mundësojë një raportim ditor, javor dhe mujor dhe orareve të lëvizjes të të gjitha mjeteve, që Autoriteti Kontraktor duhet të bashkëngjisë raporteve të monitorimit në terren, duke treguar për secilin mjet rrugetimet, kilometrat ditor, orët e punës si dhe kohën e pritjes së peshimit në landfill (hyrje dhe dalje). Do të monitorojë të gjitha lëvizjet e mjeteve teknologjike në zonat përkatëse dhe do të ketë mundësi kontrolli më të mirë në lidhje me rrugën e mjeteve, ndalesave të tyre në pikat e grumbullimit të mbetjeve, minutazhin që mjetet harxhojnë për zbrazjen e kontenerëve dhe kohën që ato harxhojnë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve. Sistemi I GPS nuk duhet të shkëputet nga lidhja me Autoritetin Kontraktor për asnjë moment si dhe nuk duhet të shkëputet nga lidhja me mjetin . Nëqk rezultat sistemi I fikur tek Autoriteti Kontraktor apo dhe tek mjetet, kontraktuesi do penalizohet.

1.8 Kushtet teknike për mjetet e transportit

a. Të gjitha mjetet e transportit duhet të jenë në gjëndje të mirë teknike për të mundësuar grumbullimin e mbeturinave.

b. Makinat teknologjike duhet të kenë një sistem ngarkimi të përshtatshëm me kontenerët që do të përdoren në NjA.

c. Sistemi mekanik i ngarkimit duhet të jetë i gjithi funksional dhe të lejojë kryerjen e një cikli të plotë (ngritjen e kontenerit, shkarkimin dhe uljen e tij (130 kg) në një periudhë kohore të limituar prej 20 sekondash.

d. Sistemi mekanik i ngritjes duhet të funksionojë vete dhe nuk duhet që puntorët të ngrenë kontenerin për ta varur atë në këtë sistem.

e. Makinat teknologjike duhet të jetë në një gjëndje të mirë, pa rrjedhje të ndonjë fluidi, dhe në gjëndje të punojë 8 orë në ditë në mënyrë të vazhdueshme pa ndërprerje për arësye mekanike. Gjithashtu ato duhet të jetë i aftë për të lëvizur me një shpejtësi prej 80 km/h.

f. Shkarkimet e gazërave të djegies nga makinat teknologjike duhet të jenë në përputhje me normat e legjislacionit në fuqi.

g. Dritat e përparme dhe të pasmet duhet të jenë në gjendje të mire dhe makinat duhet të jetë gjithashtu të pajisur me reflektorë.

h. Makinat teknologjike duhet të jenë të pajisur me pasqyra të jashtme për të pasur një vision të qartë mbrapa, me mbajtëse/suport për puntorët, me sistem komunikimi (radio ose telefona) të cilat duhet të jenë të lidhura me qendrën e operimit.

i. Sistemi i ngjeshjes duhet të jetë në gjendje të mirë për të lejuar një shkallë të mirë ngjeshje për të realizuar ngarkimin e sasisë së kërkuar të mbeturinave brenda volumit të kamionit (respektivisht 10 dhe 5 ton)

j. Të gjitha investimet, mirëmbajtja dhe në qoftë se është e nevojshme edhe kostot e zëvendësimit të pjesëve janë të gjitha për t'u paguar nga kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e të gjitha makinave dhe për faktin që ata duhet të jenë të gjithë në gjendje pune.

k. Në qoftë se një makinë është jashtë shërbimit, kontraktuesi duhet ta zëvendësojë atë me shpenzimet e tij me një makinë të ngjashme me të përgjatë gjithë kohës së riparimit të saj. Të tilla situata nuk duhet të kenë ndonjë influence apo ndikim mbi sasinë dhe cilesinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.

l. Makinat teknologjike duhet të lahen cdo ditë dhe të tregohet kujdes për to. Ato duhet të sigurojnë një grumbullim të sigurt, të pastër dhe higjienik të mbetjeve.

m. Shoferi duhet të mbajë një libër ditor ku të tregojë të gjithë informacionin për punën e bërë cdo ditë: orën kur ka filluar grumbullimi, pushimet gjatë shërbimit, orët e shkarkimit, rrugët e bëra dhe kilometrat. Përfaqësues të bashkisë mund të kenë akses tek libri ditor sipas kërkesës.

n. Kompania duhet të ketë gjithashtu një regjistër për cdo makinë teknologjike, ku të jepet i gjithë informacioni në lidhje me karburantin (datat, orët dhe sasinë), vajin dhe të tjera aktivitete të mirëmbajtjes. Përfaqësues të bashkisë mund të kenë akses tek libri ditor sipas kërkesës.

o. Në qoftë se makinat teknologjike nuk do të plotësojnë këto kërkesa, si pasojë e neglizhencës në mirëmbajtje nga kompania, atëherë njësitë administrative duhet të kërkojnë zëvendësimin e tyre.

p. Çdo mjet duhet të jetë i lidhur përmes celularit me kompaninë në vazhdimësi.

q. Çdo mjet (duke përjashtuar motorciklin) duhet të jetë i paisur me shuesin e zjarrit 6 kg, trekëndëshin e sigurisë, si dhe krik hidraulik.

1.9 Personeli

a. Personeli i nevojshëm për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është një shofer dhe dy puntorë për çdo makinë që grumbullon dhe mbetjet. Personeli nuk lejohet të kryejë riciklim në përfitim të tij apo të kompanisë gjatë orëve të punës së grumbullimit të mbetjeve në mënyrë që të evitohet humbja e kohës dhe nxitet grumbullimi. Riciklimi do të realizohet nga stafi dhe mjetet specifike. Gjatë transportit në landfill, punëtorët nuk duhet të shoqërojnë mjetin por duhet të ofrojnë të tjera shërbime pastrimi për zonën.

b. Kushtet e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kështu stafi duhet të jetë i paisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre dhe gjatë natës, me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse për sigurimin teknik në punë.

Paimet minimale të kërkuar për stafin janë:

- Veshje me vizibilitet të lart për periudhën e verës dhe dimrit
- Pantallona me vizibilitet të lartë
- Doreza
- Maska pluhuri
- Këpucë sigurie (pune)

Paimet do të zëvendosohen dhe pastrohen kur të jetë e nevojshme nga kompania kështu që punonjësit do të paisen me to gjatë gjithë orëve të punës.

Kërkesa për puntori, minimumi i kërkuar

Nr	Specialiteti	Njesi	Sasi
A	Puntore efektiv per gjithe vitin	persona	18
1	Shofere	persona	3
2	Puntor per mjetin teknologjik	persona	9
3	Drejtor teknik per kontraten	persona	1
4	Personi I zyres se kontaktit	Persona	1
5	Specialist , monitorues terreni	Persona	3
6	Mjek	Përsona	1
B	Puntore sezonal per 100 diteshin e plazhit	Persona	32
1	Shofere	Persona	3
2	Puntor makine per grumbullim mbeturina sezonal	persona	6
3	Puntore per fshirje	persona	3
3	Puntore per mirembajtje ne zonen e reres	persona	12
3	Puntore per mirembajtje tualete publike	persona	8

Kompania duhet të organizojë pastrimin e uniformave çdo javë

c. Për zonën e plazhit.

Meqënëse pastrimi i parcelave të plazheve private do të jetë një përgjegjësi e subjektit privat që e menaxhon atë plazh, pastrimi dhe mirëmbajtja e rërës (hapsirat publike) në plazhin e Velipojës dhe të Baks – Rjollit do të kryhet me puntorë sezonal. Këta puntorë do të realizojnë grumbullimin e mbeturinave, që mund të jenë të përhapura nëpër rërë, me dorë dhe me qese plastike.

Për grumbullimin e mbetjeve në hapsirat publike të plazhit të Velipojës nevojiten 10 puntorë, ndërsa për plazhet publike në Baks – Rjoll parashikohen edhe 2 puntorë të tjerë. Kjo fuqi punëtore do të punojë me dy orare: gjatë paradites 7 – 10 dhe gjatë pasdites 17 – 20 përgjatë shtatë ditëve të javës.


Gjithashtu për menaxhimin dhe mbajtjen e kushteve higjieno sanitare të banjove publike do të nevojiten të paktën dy puntorë për cdo banjo publike pra gjithësej 8 puntorë. Të cilët do punojnë dy turne 8.00 deri në 21.00.

Stafi i mësipërm do të punësohet nga Kontraktori. Kushtet e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kështu stafi duhet të jetë i paisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre dhe gjatë natës, me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse. Listat e punonjesve duhet të paraqiten Autoritetit Kontraktual 15 ditë para fillimit të sezonit.

1.10 Skenaret e lëvizjes së mjeteve për grumbullimin e mbetjeve urbane.

Zona Perëndimore (Fshati Gomsiqe – NJA Ana Malit – NJA Bërdicë - landfilli Bushati)


1 mjet 10 ton – gjatësia e rrugës 92km (një kah)



Zona Perëndimore - rrugëtimi I (Fshati Gomsiqe – NJA Ana Malit – NJA Bërdicë – landfilli Bushat)

Zona Perëndimore (Fshati Gomsiqe – NJA Velipojë – NJA Dajç - landfilli Bushati)


1 mjet 10 ton – gjatësia e rrugës 68km (një kah)



Zona Perëndimore - rrugëtimi II (Fshati Gomsiqe – NJA Velipojë – NJA Dajç – landfill Bushati)


Zona Perëndimore (Fshati Gomsiqe – NJA Velipojë zona e plazhit - landfilli Bushati)

2 mjete 5 ton – gjatësia e rrugës 74km (një kah)



Zona Perëndimore - rrugëtimi III (Fshati Gomsiqe – NJA Velipojë zona plazhit – landfill Bushati)

Përmbledhje e rrugëtimit në Zonën Perëndimore



Përmbledhje e rrugëtimit në Zonën Perëndimore

Tabela përmbledhëse për rrugëtimit në Zonën Perëndimore

ZONA PERËNDIMORE		E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E dielë
Rrugëtimi I	Ana Malit - Bërdicë							
Nisja	Fshati Gomsiqe Velipojë							
Pika fundore	Landfill Bushatit							
Gjatësia e rrugës (1 kah)	92km							
Kohëzgjatja	9h35'							
Mjeti - I	1 mjet 10ton							
Rrugëtimi II	Velipojë-Dajç							
Nisja	Fshati Gomsiqe Velipojë							
Pika fundore	Landfill Bushatit							
Gjatësia e rrugës (1 kah)	68km							
Kohëzgjatja	7h51'							
Mjeti-II	1 mjet 10ton							
Rrugëtimi III	Velipojë plazh	2 turne	2 turne	2 turne	2 turne	2 turne	2 turne	2 turne
Nisja	Fshati Mes Postribë							
Pika fundore	Landfill Bushatit							
Gjatësia e rrugës (1 kah)	50km (1 turn)							
Kohëzgjatja	7h00' (1 turn)							
Mjeti-III	2 mjete 5ton							

2. Dezifektimi i PGM

2.1 Volumet e punimeve

a. Duhet të bëhet dezifektimi i zonës përrëth kontanierëve, pas zbrazjes së çdo kontanieri, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, duke përdorur sistemin e dezifektimit manuale, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

b. Frekuenca e dizifektimit është dy herë në javë për periudhën Maj-Shtator (ditë merkure dhe shtune) , ndërsa periudhën tjetër te vitit Tetor - Prill 2 (dy) here në muaj.

3. Menaxhim dhe mirëmbajtje kontanieresh.

Pronësia e kontanierëve është e Autoritetit Kontraktor, ndërsa Kontraktuesi do të jenë përgjegjës për ruajtjen ,menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

3.1 Menaxhimi i kontanierëve:

a. Vendosja e kontanierëve do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor. Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi mund të zhvendosin kontanierë (duke ruajtur numrin rendor të tyre) në sajë të një kërkesë fillestare të bërë dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Të gjitha lëvizjet e kontanierëve janë të përfshirë nëçmimin e kontratës. Kontraktuesi duhet të ketë një mjet që do të mundësojë zhvendosjen e të paktën 8 kontanierëve (min 5.5m * 2.2m).

b. Kontanierët do të identifikohen me një numër rendor dhe një barkod, që do të mundësojë identifikimin digital të tyre nga grupi i monitorimit në Bashki. Kontraktuesi duhet të mbajnë një databazë me të gjithë kontanierët, ku identifikohet pozicioni, numri, mosha, kushtet dhe riparimet. Shërbimet e bashkisë do të kenë akses të përhershëm në leximin e kësaj database.

c. Sipërmarrësi i shërbimit është i detyruar të zëvendësojë në mënyre progressive 15 % të kazanëve të dëmtuar ose të vjetër çdo vit kalendarik. Konkretisht do blihen 60 (gjashtedhjetë) kazane metalike te xinguar 1100 litrash, me mbulose metalike me rrota, sipas normave EN DIN 840 dhe do blihen ne fund te cdo gjashtemujore. Furnizimi dhe me pas ndarja do behet ne marreveshje me Autoritetin Kontraktor. Numri I kazaneve qe do blihen do te jete:

-Për gjashtëmujorin e parë të vitit do blihen nga 40(katërdhjetë) kazane.

-Për gjashtëmujorin e dytë te vitit do blihen nga 20 (njëzet) kazane.

Për mosrealizim të blerjeve të kazaneve sipas planit , Sipërmarrësit në fund të çdo gjashtëmujori në situacione, do ti ndalet vlera e kazaneve të pa blerë.

3.2 Mirëmbajtja e kontanierëve:

a. Kontanierët e dëmtuar sistematikisht duhet të zëvendësohen me një të riparuar, transportohen dhe rregullohen nga kontraktuesi. Kontraktuesi kanë për detyrë të monitorojnë rregullisht gjendjen fizike të kontanierëve, dhe të mbajnë një inventar për të gjithë kontanierët, të cilin duhet ta raportojë te Autoriteti Kontraktues. Në këtë inventar kontraktuesi duhet të japin sugjerimet në rast të nevojës për zëvendësim të kontanierëve, atëherë kur është e nevojshme si shtesë e kontanierëve të siguruar sipas pikës 3.1.c . Për të riparuar kontanierët, kontraktuesi duhet të ketë një mjet të veçantë për transportin e kontanierëve për t'i riparuar ato në ambjentet e kompanisë.

b. Kontraktuesi duhet të mbajnë një rezervë prej 10(dhjetë) kontanierësh, të cilët do të përdoren për zëvendësimin e atyre të cilët do të shkojnë për riparim. Dëmtimet e mundshme, të cilat riparohen mbrenda 5- ditëve të evidentimit, janë:

- rrotat,
- kapakët,
- dorezat,

- deformime të ndryshme të kontenierit.
 - ljerja e kontanierëve, numri serial dhe barkodi
- c. Përsa kohë konteneirët janë projektuar për një përdorim intensiv, ata nuk duhet të kenë nevojë për riparime nëse ato trajtohen ashtu siç duhet gjatë procesit të grumbullimit të mbetjeve. Pas grumbullimit kontenierët duhet të vendosen në pozicionin e tyre të mëparshëm.
- d. Kontraktuesi duhet të kenë në dispozicion materialet dhe stafin e përshtatshëm për të realizuar këtë shërbim si dhe një oficinë të pajisur me mjetet dhe pajisjet e nevojshme.

3.3 Larja e kontanierëve

Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezinfektojë 410 kontenierë të volumeve 1.1 m³/ brenda muajit ose mesatarisht 13 kontenierë/ditë, sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor.

• Metodologjia

1. Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucione larëse.
2. Me shërbim dezinfektimi kuptojmë realizimin shërbimit të dezinfektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.
3. Larja bëhet në pikat e grumbullimit nga mjete që ka dhe cisternon me ujë.

• Grafikët e punimeve

1. Grafikët e punimeve për larjen e kontenierëve, përgatiten nga Kontraktuesi dhe miratohen nga Autoriteti kontraktor.
2. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Kontraktuesi.
3. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

• Mjetet dhe pajisjet

1. Makine transportuese me cisterno uji për larjen minimalisht të 10 kontanierëve në ditë.
2. Lëndë dezinfektuese dhe aromatizuese për dezinfektimin e kontenierëve.

4. Fshirja e manuale e rrugëve

4.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti kontraktor ka parashikuar për fshirjen manuale sheshet, rrugët në qendër të plazhit si dhe pedonalen e saj sipas grafikut.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjithë sipërfaqen e parashikuar në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej 23 836 m²/ditë. Këto janë parashikuar në grafikun e listës së rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes.

4.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në:

- a. Fshirjen me punëtorë me fshesë të gjithë sipërfaqes së përcaktuar dhe detajuar sipas grafikut..

- b.** Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi.
- c.** Operatori i shërbimit duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat rrugorë brenda zonës së kontraktuar. Për këtë operojnë punëtorë dhe makina të veçanta. Shërbimi i zbrazjes dhe pastrimit të ambientit rreth tyre bëhet gjatë natës.
- d.** Proçesit të fshirjes dhe pastrimit i nënshtrohen të gjitha rrugët dhe trotualet e parashikuara në zonën e kontraktuar .

4.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

- a.** Fshirja e rrugëve do të bëhet një herë në ditë në mëngjes nga ora 04.00-07.00 dhe do të planifikohet në mënyrë të tillë që fshirja të kryhet përpara grumbullimit të mbetjeve në çdo rrugë
- b.** Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zones, përgatiten nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në destinacione apo dhe në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.
- c.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.
- d.** Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

4.4 Rregulla për t'u zbatuar

- a.** Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e Kontraktorit.
- b.** Kontraktori detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.
- c.** Për raste të veçanta Kontraktori është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.
- e.** Gjatë proçesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse , zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie Kontraktori detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes , përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.
- g.** Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoba për mosplotësim të tyre.

4.5 Mjetet dhe pajisjet

Kontraktori duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- a. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
- b. Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë.
- c. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur me uniforme. Paimet e personelit do të jenë njelloj sipas pikës 1.9

5. Mbetjet e ndërtimit dhe inertet

Kompania do të gjejë një zgjidhje (vend specifik) për marrjen, trajtimin e mundshëm (riciklimin) dhe depozitimin e inerteve dhe mbetjeve të ndërtimit. Në bashkëpunim me Bashkinë, do të përcaktohet dhe organizohet vendi. Vendi do të paiset nga kompania, brenda 1 (një) viti nga fillimi i kontratës.

Me mbështetjen e Bashkisë, kompania do të zhvillojë fushata komunikimi me pronarët e ndërtimeve, ndërtuesit dhe kompanitë e transportit në mënyrë që:

- Të përcaktohet që për të gjitha kompanitë dhe pronarët e ndërtimit duhet të shkojnë në vendin e përcaktuar me mbetjet inerte apo të ndërtimit. Të përcaktojnë çmimin dhe kushtet për pranimin e mbetjeve inerte në këtë vend.
- Ndalimin e përdorimit të kazaneve të Bashkisë për evadimin e mbetjeve të ndërtimit dhe inerteve.
- Propozojë shërbimin e kompanisë për depozitimin, grumbullimin dhe transportimin e inerteve apo mbetjeve të ndërtimit në vendin e dedikuar, me një çmim të përcaktuar nga kompania.
- Të përcaktojnë së bashku me Bashkinë penalitetet (të rënda) për mbetjet inerte dhe të ndërtimit të hedhura në vendin e gabuar si rrugë, hapsira publike apo vende private.
- Të përcaktojnë, së bashku me Bashkinë, procedurat e autorizimit për përdorimin e hapsirave publike (rrugë dhe trotuare) për një depozitim të përkohshëm të mbetjeve inerte dhe të materialeve të ndërtimit, si dhe koston e këtij shërbimi.

Për këtë shërbim privat kompania do të sigurojë kamionet dhe kontenieret specifik, me kosto të pronarit ose kompanisë së ndërtimit.

6. Mbetjet e rënda dhe voluminoze

Kompania do të gjejë një zgjidhje (kamion kompaktues dhe mjete të tjera specifike) për grumbullimin e mbetjeve të rënda dhe voluminoze dhe transportimin e tyre në landfill. Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve të rënda dhe voluminoze do të organizohet me kosto të pronarit të mbetjeve.

Me mbështetjen e Bashkisë, kompania do të zhvillojë fushate komunikimi me qytetarët në mënyrë që të:

- Përcaktohet që të gjithë pronarët e mbetjeve të qojnë mbetjet e rënda dhe voluminoze në landfill me kosto të tyre.
- Propozojnë shërbimin e kompanisë për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve të rënda dhe voluminoze, sipas kërkesës dhe kostimit të përcaktuar nga kompania.
- Të përcaktojnë dhe vendosin kushtet për pranimin e mbetjeve të rënda dhe voluminoze.
- Të ndalojnë përdorimin e kazanëve të Bashkisë për evadimin e mbetjeve të rënda dhe

voluminoze.

- Të përcaktojë së bashku me Bashkinë penalitetet (të rënda) për hedhjen e mbeturinave të rënda dhe voluminoze në vendin e gabuar si koshat e mbeturinave, rrugë, hapsira publike, lumenj apo vendet private.

7. Mbetjet e kopshteve dhe sasite e medha të mbetjeve organike.

Kompania do të sigurojë një zgjidhje (vend specifik) për marrjen, trajtimin e mundshëm (kompostimin), dhe depozitimin e mbetjeve të pastra organike. Në bashkëpunim me Bashkinë, do të përcaktohet dhe organizohet vendi. Vendi do të paiset nga kompania, brenda një viti nga fillimi i kontratës.

Me mbështetjen e Bashkisë, kompania do të zhvillojë fushatë komunikimi me pronarët e kopshteve dhe bizneset në mënyrë që:

- Të përcaktojë që të gjithë pronarët e kopshteve dhe bizneset duhet të mbajnë mbetjet e tyre organike në kopësht, të kryejnë vetë aktivitetin e kompostimit ose të depozitojnë në vend mbetjet organike.
- Të përcaktojnë çmimin dhe kushtet për pranimin e mbetjeve organike në vendin e caktuar.
- Ndalojnë përdorimin e koshave të Bashkisë për evadimin e mbetjeve të kopshteve apo sasive të mëdha të mbetjeve organike (më shumë se 1 m³ / ditë ose 300 kg / ditë).
- Propozojnë ofrimin e shërbimit të depozitimit, grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve organike në vendin e dedikuar nga kompania, në vendin e përcaktuar nga kompania.
- Të përcaktojë së bashku me Bashkinë, penalitetet (të rënda) për hedhjen e mbeturinave organike dhe të kopshteve në vendin e gabuar si rrugë, hapsira publike apo hapsirat private.
- Për këtë shërbim privat, kompania do të sigurojë kamionet dhe kontenieret specific, me kosto të pronarëve të kopshteve ose të bizneseve të interesuara.

8. Vendi i depozitimit të mbetjeve

Mbetjet urbane do të depozitohen për trajtimin përfundimtar në landfill-in e Bushatit.

Kosto e depozitimit është fikse dhe do të përfshihet në ofertën financiare të Ofertuesit mbi bazen e cmimit njësi aktual të depozitimit në Landfill-in e Bushatit

Nëse cmimi i depozitimit do të ndryshojë, atëherë ky ndryshim do të reflektohet në koston e këtij shërbimi në baze vjetore.

Mbetjet urbane të riciklueshme do të trajtohen nga vete Kontraktori, sipas nje marreveshje qe do beje me bizneset.

Të gjitha mjetet e kompanisë që transportojnë mbetje në landfill duhet të peshohen në hyrje dhe në dalje nga landfilli. Statistikat për secilin mjet, përfshire hyrjet dhe daljet, sasitë, datën, orën e hyrjes dhe orën e daljes, identifikimin e mjetit, duhet të regjistrohen dhe ti kalohen bashkisë një herë në ditë në format digjital exel.

Cdo tentative e shoferit apo e kompanisë për të ndryshuar rezultatet e peshimit të mbetjeve dhe të japë vlera të gabuara për mbetjet e transportuara do të qojë drejt penaliteteve, shkëputjes së

mundshme të kontratës si dhe / ose procedime penale.

9. “Edukimi Publik Mjedisor”

a. Në termin “Edukim Publik”, do të nënkuptohet aktiviteti publicitar i Kontraktori për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbetjeve, grafiket, rrugetimet, praktikat e mira dhe te keqija te qytetareve dhe bizneseve, ndarjes së mbetjeve në burim, etj periudhës së kontratës.

b. Kontraktori duhet të krijojë një kontakt të vazhdueshëm me komunitetin e zonës i cili luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbarëvajtjen e punës së Kontraktorit por edhe në minimizimin e ndotjes së ambientit.

c. Programi i edukimit mjedisor që do të bëjë operatori i shërbimit duhet të miratohet nga Autoriteti kontratues.

d. Buxheti që Sipërmarrësi duhet të shpenzojë për edukimin mjedisor, është i përfshirë në koston e zerit të shërbimit “Grumbullim ,transport i mbetjeve urbane” (sipas llogaritjes së koston në bazë të VKM). Masa e buxhetit është 5 % e vlerës së këtij zëri të shërbimit në preventiv

10. Pajisja e punonjësve me uniforme.

a-Kontraktori duhet të pajisë të gjithë punonjesit e vete me uniforme të njëjtë.

b-Uniforma duhet të ketë të stampuar siglën e Kontraktuesit , si dhe të Autoritetit Kontraktor. Kjo në dakortësi ndërmjet palëve.

c-Punonjësit duhet të pajisen me uniforme verore dhe dimërore, model i miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

d-Mbrenda tre muajve të fillimit të kontratës, të gjithë punonjësit duhet të jene të pajisur me uniformën.

e-Nuk lejohet për asnje lloj arsye që punonjesit të mos kene të veshur uniformën e përcaktuar, në të kundërt ,penalizohet.

11. Minimizimi i mbetjeve

Sipas VKM nr. 48, datë 25.06.2017 “Për grumbullimin e ndarë të mbetjeve në burim”, janë përcaktuara disa objektiva, të cilat duhet të plotësohen nga NJQV-të deri në vitin 2020, ku konkretisht:

- NJQV-të deri në fund të vitit 2018, NJQV-të duhe të grumbullojnë në mënyrë të diferencuar, të paktën mbetje të letrës, metalit, plastikës dhe qelqit;
- Brenda vitit 2020, ato duhet të arrijnë normën e riciklimit me 50% të sasisë të mbetjeve të vitit 2014;
- Brenda vitit 2020, sasia e mbetjeve që shkojnë në landfill do të jetë 45% e sasisë së të mbetjeve që prodhohet, dhe pjesa tjetër duhet të shkojë për riciklim, kompostim apo për rekuperim me energji.

Kompostimi i mbetjeve: Një argument i rëndësishëm në favor të kompostimit është fakti se këto NJA kanë karakter suburban dhe kryesisht rural, dhe sasia e mbetjeve organike, kryesisht nga kopshtet, bujqësia apo blegtoria në zonë, përbëjnë një sasi të konsiderueshme për zhvillimin e kompostimit familjar (individual) dhe kolektiv.

Kompostimi në nivel individual (në shtëpi) paraqet një nga metodat më të parapëlqyera të

kompostimit që rekomandohet për t'u përdorur në familjet në zonat suburbane apo rurale. Kjo metodë është më pak e kushtueshme dhe më e efektshme sesa transferimi i mbetjeve organike në pikën e mbledhjes dhe më pas transportimi i tyre në landfill, ku përfshihen edhe depozitimi si dhe të gjitha kostot e tjera që shoqërojnë këto procese. Ky proces është mjaft i rëndësishëm nga ana mjedisore, pasi ul ndjeshëm sasinë e mbetjeve që hedhin familjet për trajtim final, duke ulur në këtë mënyrë edhe koston transportit dhe të trajtimit final të mbetjeve.



Modeli i kompostimit individual

Përveç kompostimit në nivel individual, një ndër metodat më të përshtatshme për kushtet dhe koston relativisht të ulët që ka, mund të jetë **kompostimi në mjedis të hapur (kolektiv)**. Kjo metodë nuk ka një kosto të lartë për investimin fillestar dhe mund të japë rezultate mjaft të favorshme, jo vetëm për uljen e sasisë së mbetjeve që shkojnë për trajtimin final, por edhe në prodhimin e një sasive të konsiderueshme komposti si pleh organik, që mund të përdoret nga bashkia për qëllime publike.

Kontraktori do të grumbullojë mbetjet me mjetin teknologjik për këtë shërbim dhe do të transportojnë ato në pikat e kompostimit (gropat) në komunitet në secilën nga Njësitë.njësitë.Kontraktori duhet të sigurojë që mbetjet organike të kthehen në kompost në sajë të përdorimit të produkteve të posaçme për kryerjen e këtij procesi (vermikompost).



Skemat e kompostimit në mjedis të hapur

Linda Bala

Eva Pohja

Ilo Hajkoja